



KOMUNA E SUHAREKËS  
OPSTINE SUVA REKA



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



NPL "EKO-THERANDA"  
SH.A. SUHAREKË

## BORDI I DREJTORËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE NË SUHAREKË

Në bazë të nenit 8, të Ligjit Nr. 02/L-212 të punës, të shpallur në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-90/2010", e në zbatim të nenit 5, të Udhëzimit administrativ MFTP-Nr.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, e në mbështetje të nenit 16 paragrafi 3, të Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale, "Eko-Theranda" në Suharekë, 01-Nr-110-43163, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Theranda në Suharekë, shpall këtë:

### K O N K U R S

#### Për plotësimin e vendeve të lira të punës

**Titulli i vendit të punës:** 3, (tri) pozita Punëtor Fizik

**Përgatitja profesionale/shkollore:** E mesme e ulët (fillore), shkathtësi në punë.

**Vendi i Punës:** NPL-ja "Eko-Theranda" në Suharekë

**Kohëzgjatja e kantatës:** Me kohë të pacaktuar (me një periudhë të punës provuese prej 6, gjashtë muaj)

**Orari i punës:** I plotë

**Paga:** Sipas Rregullores së brendshme të NPL-ja "Eko-Theranda" në Suharekë

**Procedura e aplikimit:** Konkurs i jashtëm

#### Përshkrimi i Detyrave dhe Përgjegjësi të Punës:

1. Te jete i afte qe me orar te plote dhe pa kufizime te kryej detyrat e punës
2. Kryer të gjitha punët fizike në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, zbrazjen e kontejnerëve dhe pastrimin e lokacionit për rrethe tyre;
3. Sipas planit operativ dhe planit të punës ditor bënë fshirësen, pastrimin dhe larjen e rrugëve, apo pastrimin e rrugës dhe trotuareve nga bora dhe akulli si dhe hedhjen e kripës;
4. Bënë larjen e automjeteve të ndërmarrjes;
5. Pastrimin dhe menaxhimin e varrezave të qytetit;
6. Ujitja e luleve dhe drunjëve dekorativ në lokacione të ndryshme të qytetit, etj.
7. Bënë largimin e qenve dhe maceve të ngordhura dhe i vendosin ne lokacionin e caktuar;
8. Bën pastrimin e nevojshëm të gjitha hapësirave që disponon ndërmarrja publike lokale "Eko-Theranda" SH.A. në Suharekë;
9. Kujdeset për vendosjen e pajisjeve dhe orendive në vendin e duhur;
10. Kujdeset për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruar në ndërmarrjen publike lokale;
11. Kosi-jen e barit dhe drunjëve për rrethe rrugëve;
12. Bënë mirëmbajtjen dhe pastrimin e të gjitha objekteve publike dhe private;
13. Është i obliguar te përdorë dhe kujdeset për mjetet përkatëse ne pune;
14. Kryen edhe punë dhe detyra të tjera të caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv;

## INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Kandidatët për pozitën punëtor fizik i Ndërmarrjeve Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Aplikacioni (formularin) për konkurrim
- CV-në
- Letër motivimin
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Certifikata shëndetësore sillet pas konfirmimit të pranimin në punë
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Të interesuarit aplikacionin (formularin) mund ta marrin për ta plotësuar në Zyrën Nr. 1 (zyra e pritës) në Administratën e Komunës në Suharekë me seli në Rr. “Br. 123”.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike Lokale në të cilën konkurren kandidati dhe të dorëzohen në Zyrën Nr. 1 (zyra e pritës) në Administratën e Komunës në Suharekë me seli në Rr. “Br. 123”.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet mund të kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 029/ 272/ 662.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë të cilit i plotësojnë kushtet dhe kriteret e paraparë sipas këtij konkursi.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit nga popullata jo-shumicë dhe të interesuarit që do të përfaqësojnë interesat e Komunës ku Ndërmarrja Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë, vepron që të aplikojnë në konkursin për pozitën Punëtor Fizik të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Theranda” SH.A. në Suharekë.

Afati i konkursit është i hapur 15, (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e publikimit në ueb faqe zyrtare dhe tabelën e shpalljeve (prej datës 01 shtator 2025 deri më datën 15 shtator 2025).

**Vërejtje:** Aplikacionet pranohen vetëm ata të cilët dozohen me kohë në pliko (zarf) të mbyllura, ndërsa ato të dërguar pas afatit për aplikim dhe të pakompletuar nuk do të shqyrtohen.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Korab MUQA

